



Kremtimi i Vitit të Ri, një feste pagane, përveç tjerash ka demonstruar xhelozinë e dobët që muslimanët (veçanërisht ata shqiptarë) kanë për fenë e tyre. Nuk mjaftuan sqarimet, këshillat e vërejtjet që të mos kremtohet Viti i Ri, festë kjo që rrezikon skajshmërisht identitetin islam të besimtarit. Përkundrazi, si për inat, njerëzit shpenzuan edhe më shumë, e edhe më shumë do të shpenzonin po të kishin para më shumë...

E rëndësishme, siç theksuam, është që kjo festë ka sfiduar një element qenësor të karakterit dhe identitetit tonë. A nuk është përbuzje e gjithë atyre të mirave të Zotit që ia ka dhënë njeriut festimi dhe kremtimi i një gjëje që hidhëron pa masë Atë? A kemi harruar se gjithë të mirat që i posedojmë, i kemi prej Allahut, madje, si për çudi, ne me to, i bëjmë Allahut mëkat. Pra, ai na ka dhënë të mira ndërsa ne ato i shfrytëzojmë për t'i bërë mëkat Atij. Allahu i Madhëruar ka thënë:

Dhe Ai ju dha gjithatë që e kërkuat (që kërkoi nevoja juaj) dhe, edhe në qoftë se përpiqeni t'i numëroni të mirat e All-llahut, nuk do të mund të arrini t'i përkufizoni (në numër). Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë përbuzës." (Ibrahim, 34)

Allahu xhelozon

Nuk do të ishte aspak për çudi nëse themi se Zoti që i ka dhuruar njeriut gjithë këtë thesar mirësish, xhelozon nëse njeriu përbuz ato apo i bën mëkat Atij. Buhariu transmeton në Sahihun e tij nga Ebu Hurejre se Pejgamberi, alejhis selam ka thënë:

"????? ??????? ??????? ????????????? ??????? ????? ?????????? ????????????????? ?????????? ?????????? ??????????"

Vërtetë, Allahu xhelozon ndërsa xhelozia e Tij është që besimtari të bëjë mëkate."

Pra, Allahu xhelozon kur robi/robëresha kalon natën në mëkate ndërsa harron ta përkujtojë Atë. Allahu xhelozon kur robi/robëresha feston diç që atakon drejtpërdrejtë besimin e pastër në Të. Allahu xhelozon kur ti ia përkushton dikujt dashurinë që do të duhej t'ia përkushtoje vetëm Atij.





Ndryshe, mund të jemi shkaktarë të ndonjë të keqe edhe më të madhe. Allahu i Madhëruar ka thënë: Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira...” (en-Nahl, 125)

Bazuar kryesisht në: <http://www.saaid.net/Doat/aljefri/14.htm>

Përshtati dhe përgatiti: [Sedat ISLAMI](#)